


POLICY MEMO

Marrëveshjet dhe barrierat tregtare në mes të Kosovës dhe Shqipërisë



Deklaratë mohimi:

Gjetjet, opinionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë studim janë të autorëve dhe të kontribuesve institucionalë. Si të tilla, ato nuk reflektojnë medoemos pikëpamjet e Fondacionit të Shqipërisë për Shoqëri të Hapur dhe të Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur.

Dizajni dhe Faqesja:

Envinion

Origjinali është shkruar në shqip.



Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr.4,
10000 Prishtinë
+383 38 609 339
info@institutigap.org



Rr. Ymer Kurti, Nd.5, H.5, Ap.4
1019 Tirane
+355 686031485
info@acit.al



Rr. Lidhja e Prizrenit, Nr.56,
10000 Prishtinë
+383 38 244 320
riinvest@riinvestinstitute.org



Imzot Nike Prela vila 13
Pristina, Kosovo
Tel: +381 38 542 157
Fax: +381 38 542 157 ext. 111
info@kfos.org



Rr. Qemal Stafa, Pallati 120/2
1001 Tirane
+355 42234621
info@osfa.al

POLICY MEMO

Marrëveshjet dhe barrierat tregtare në mes të Kosovës dhe Shqipërisë

Shqipëria dhe Kosova janë partnerë të rëndësishëm tregtarë për njëra-tjetrën. Për Kosovën, Shqipëria zë vendin e parë sa i përket eksporteve dhe vendin e pestë sa i përket importeve. Shqipëria është e rëndësishme për Kosovën edhe për arsye se më shumë se një e treta e produkteve të tregtuara në Kosovë kalojnë transit përmes saj. Nga ana tjetër, edhe Kosova është partner i rëndësishëm për Shqipërinë, duke qenë i vetmi vend me të cilin ka suficit tregtar. Pavarësisht shkëmbimit tregtar në rritje dhe përpjekjeve për thellim të bashkëpunimit ekonomik me anë të marrëveshjeve të shumta, potenciali për rritje të shkëmbimeve tregtare për të dy vendet mbetet i pashfrytëzuar dhe barrierat tregtare janë ende duke penguar integrimin ekonomik midis tyre.

Qëllimi i dy studimeve të zhvilluara në këtë kuadër, përkatësisht nga **Instituti GAP** dhe **Instituti për Humtime Zhvillimore Riinvest** për Kosovën, si dhe nga **Qendra Shqiptare për Konkurrueshmërinë dhe Tregtinë Ndërkombëtare (ACIT)** për Shqipërinë, është nxitja dhe përshpejtimi i integritimit ekonomik dhe tregtar midis Shqipërisë dhe Kosovës, duke ndërgjegjësuar politikëbërjen, institucionet dhe komunitetin e biznesit të përfshirë në procesin e eliminimit të barrierave tregtare ekzistuese, mbi potencialet e pashfrytëzuara dhe fushat prioritare.¹ Për këtë qëllim, studimet janë fokusuar në disa aspekte duke përfshirë: a) një anal-

izë statistikore mbi të dhënat e tregtisë midis dy vendeve, si dhe një studim i thelluar i potencialeve tregtare të pashfrytëzuara; b) identifikimin e barrierave tregtare bazuar në gjetjet e në bazë të intervistave me përfaqësues të biznesit, si dhe intervista të thelluara me përfaqësuesit e institucioneve të përfshira në hartimin dhe monitorimin e politikave të nxitjes së bashkëpunimit ekonomik midis vendeve; c) një monitorim i thelluar i shkallës së zbatimit të marrëveshjeve dypalëshe midis Shqipërisë dhe Kosovës. Gjithashtu, studimet dalin me një sërë rekomandimesh konkrete për të lehtësuar zhvillimin e tregtisë dhe të integritimit ekonomik midis dy vendeve, të cilat janë të përmbledhura në fund të këtij dokumenti.

Ky dokument përmbledh gjetjet dhe rekomandimet e të dy studimeve, duke integruar bashkë perspektivat e Shqipërisë dhe Kosovës. Këto studime janë pjesë e projektit “**Shqipëri – Kosovë, Dekonstruktimi i idesë së bashkimit nëpërmjet nismave rajonale të përbashkëta**”. Ky projekt është iniciuar dhe mbështetur financiarisht nga **Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA)** dhe **Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS)**.

¹ Studimin nga perspektiva e Kosovës mund ta gjeni këtu: <https://bit.ly/2VGkgcS>, ndërsa nga perspektiva e Shqipërisë këtu: <https://bit.ly/2VNASzh>

Tregtia dhe potencialet e pashfrytëzuara

Pavarësisht rritjes së flukseve tregtare dhe bashkëpunimit ekonomik midis dy vendeve në 10 vitet e fundit, të dy ekonomitë shfaqin dobësi strukturore të cilat pengojnë shfrytëzimin e potencialit për shkëmbime të mallrave. Një nga problemet kryesore është përqëndrimi shumë i madh i tregtisë, ku vetëm 4 grup-produkte zënë mbi 80% të flukseve tregtare midis dy vendeve. Kjo ka krijuar edhe një paqëndrueshmëri në kohë, e cila dëmton konkurrueshmërinë e ekonomive dhe tërheqjen e investimeve.

Midis kategorive që tregtohen, ka një potencial të madh të pashfrytëzuar për shkak të kostove dhe barrierave që ulin avantazhet. Kështu, për sa i përket potencialeve të Shqipërisë për të eksportuar në Kosovë, në sektorë si agro-përpunimi dhe industria ushqimore, punimet artizanale, prodhime druri dhe qelqi, përpunimi i plastikës dhe metaleve, etj. rezultojnë një mundësi për të dyfishuar shkëmbimet tregtare.

Për eksportin e Kosovës në Shqipëri, dy sektorët me potencial më të madh për rritje janë ai i prodhimit të mallrave dhe sektori i furnizimit të energjisë elektrike. Prodhimi i metaleve bazë, produkteve ushqimore, gomës dhe plastikës, metaleve të ndryshme, prodhimi i pijeve kanë më së shumti potencial indika-

tiv për eksport më të shtuar nga Kosova në Shqipëri.

Potenciali është akoma më i madh dhe i qëndrueshëm për specializim të bashkëpunimit ekonomik dhe rritje të konkurrueshmërisë, me anë të konsolidimit të zinxhirit të vlerës nëpërmjet shkëmbimeve ndër-sektoriale. Vlerat e indeksit të paraqitura ndër vite tregojnë që tregtia ndër-sektoriale është sistematikisht më e lartë në produktet e drurit, gurit, plastikës, pijeve, zarzavateve dhe drithërave. Potenciali i pashfrytëzuar në këtë lloj tregtie është sidomos në fusha si agro-përpunimi, industria kimike dhe kozmetike, prodhimi i artikujve të paketimit prej plastike dhe letre, përpunimi i metaleve, etj



Dy sektorët me potencial më të madh për rritje të eksporteve të mallrave nga Kosova në Shqipëri janë ai i prodhimit të mallrave dhe sektori i furnizimit të energjisë elektrike.

Pengesat e identifikuara

Operatorët ekonomikë që zhvillojnë aktivitetin e tyre tregtar midis dy vendeve, raportojnë një numër të konsiderueshëm barrierash tregtare. Të dy vendet përballen me korrupsion të përhapur, nivel të ulët të arsimit dhe zhvillimit industrial, ekonomi të lartë informale etj. Mungesa e theksuar e besimit që konstatohet nga administratat përkatëse, krijon shpesh bllokime dhe vonesa në zhvillimin e tregtisë. Kjo reflektohet edhe në mosnjohjen reciproke të disa prej dokumentacioneve dhe certifikimeve bazë që shoqërojnë procesin. Duhet theksuar, se një mungesë besimi raportohet edhe midis bizneseve të dy vendeve. Të gjithë këta faktorë janë pengesë edhe për shkëmbimet tregtare. Problemet kryesore të bizneseve në shkëmbimet midis dy vendeve janë të përmbladhura si më poshtë, jo të renditura sipas rëndësisë:

- Korrupsioni në administratat doganore përkatëse;
- Kostot e larta të transportit, të rënuara edhe nga tarifatat rrugore;
- Kërkesat për noterizim të dokumentacionit fitosanitar;
- Praktikatat e zhdoganimeve: kohëzgjatja dhe inspektimet e shpeshta e të tepruara;
- Tarifatat e larta të skanimit, tarifa parkimi, peshimi, etj., të gjitha mbi koston efektive;
- Akciza diskriminuese për disa nga produktet;
- Mos-shfrytëzimi i procedurave të lehtësuara për eksportuesit e Kosovës në portin e Durrësit;
- Tarifa e skanimit 22 Euro në Durrës (rreth 2 milionë Euro kosto në vit, edhe pse skaneri nuk është në funksion tek Zyra Doganore e Kosovës në Portin e Durrësit);
- Mospublikimi i çmimeve të referencës dhe aplikimi i çmimeve rast pas rasti;
- Kufizime edhe nga pamundësia e zbatimit dhe përfitimit nga rregullat e origjinës.



Mungesa e theksuar e besimit që konstatohet nga administratat përkatëse, krijon shpesh bllokime dhe vonesa në zhvillimin e tregtisë.

Zbatimi i marrëveshjeve

Pavarësisht nënshkrimit të një sërë marrëveshjesh midis dy vendeve, zbatimi i tyre paraqet ende probleme dhe vështirësi të theksuara. Vullneti politik i shpalosur herë pas here nga dy qeveritë në mbledhjet e përbashkëta e më gjerë, nuk është përkthyer në mënyrë të kënaqshme në zbatim konkret dhe në lehtësim të konsiderueshëm të barrierave tregtare, disa prej të cilave të identifikuar më lart.


Me qëllim të matjes së zbatimit të marrëveshjeve tregtare të nënshkruara nga Kosova dhe Shqipëria, janë identifikuar rreth 53 objektiva apo detyrime konkrete që dalin nga marrëveshjet tregtare Kosovë – Shqipëri. Në bazë të të gjeturave, 49% e këtyre objektivave janë realizuar plotësisht, 36% janë realizuar pjesërisht, 9% nuk janë realizuar fare ndërsa për tre objektiva nuk kemi mundur të marrim përgjigje.

Objektivat kryesore të marrëveshjeve të pazbatuara plotësisht janë:

- Mos-mbajtja e takimeve të rregullta të niveleve teknike si pasojë e varësisë së madhe në nivelin politik;
- Shmangia e çmimeve arbitrare;
- Procedurat e dyfishta gjatë transitit të

produkteve – peshimi që bëhet në Shqipëri nuk merret për bazë në Kosovë, etj.;

- Detyrimet në fushën e harmonizimit të standardeve për produktet ushqimore;
- Bashkëpunimi në fushën e akreditimit të laboratorëve;
- Harmonizimin e legjislacionit për kontrolle me bazë risku;
- Unifikimin e dokumentacionit për produkte me origjinë jo-shtazore;
- Shmangia e kontrolleve të dyfishta;
- Pamundësia për të shfrytëzuar Portin e Durrësit nga Dogana e Kosovës sa i përket eksporteve;
- Mungesa e transparencës me mos-publikimin e informacioneve online.

 **49%** e këtyre objektivave janë realizuar plotësisht, **36%** janë realizuar pjesërisht, **9%** nuk janë realizuar fare ndërsa për tre objektiva nuk kemi mundur të marrim përgjigje.

Rekomandimet

Shumë nga problemet e shfaqura në marrëdhëniet tregtare dypalëshe lidhen me element thelbësorë të shtetit dhe qeverisjes si sundimi i ligjit, zbatimi i kontratave, ulja e korrupsionit, etj. Krahas këtyre, duke marrë parasysh gjetjet nga analiza dhe opinionet e bizneseve, një sërë rekomandimesh konkrete janë formuluar nga ekspertët e përfshirë në dy studimet. Propozimet fokusohen si në çështje specifike, ashtu edhe në qasjen strategjike që dy qeveritë do të duhet të adoptojnë për të zhvilluar më tej tregtinë dhe për të integruar ekonomikisht dy vendet. Objektiv kryesor i rekomandimeve është pikërisht zbatimi i marrëveshjeve, eliminimi i barrierave dhe shfrytëzimi i potencialeve ekzistuese. Për këtë qëllim, rekomandohet:

1. Ngritja e një strukture dypalëshe të qëndrueshme, me përfaqësi politike dhe teknike, me mandat të qartë dhe me detyrë monitorimin dhe shpejtimin e zbatimit të marrëveshjeve, heqjen e barrierave dhe ndjekjen e hapave të tjerë drejt integritetit ekonomik;
2. Hartimi i një strategjie dhe një plani veprimi për integrimin tregtar dhe ekonomik, duke integruar marrëveshjet ekzistuese dhe të reja, për të ruajtur koherencën dhe maksimizuar ndikimin;
3. Nënshkrimi i marrëveshjeve të reja për harmonizimin e legjislacionit për taksat dhe akcizat;
4. Heqja e barrierave ekzistuese në kuadër të vendosjes dhe themelimit të biznesit në të dy vendet;
5. Krijimi i instrumenteve të përbashkëta (p.sh. Fond i Përbashkët Investimi), me synim mbështetjen e politikave të përbashkëta zhvillimore, sidomos në sektorët e identifikuar në studimet, sidomos në sektorët e të cilët konsolidojnë zinxhirin e vlerës dhe si dhe të kategorive që kanë potencial konkurrues në rajon e më gjerë.
6. Plotësimi i vendimit për përdorimin e Portit të Durrësit nga Dogana e Kosovës për eksport, jo vetëm për import.

